



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 629 Prot

Date 31 .03.2026

VENDIM

Nr. 17, datë: 31.03.2026

**“PER MIRATIMIN E RAPORTIT TE PERFORMANCES SE KESHILLIT BASHKIAK
DROPULL PER VITIN 2025”**

Në mbështetje të ligjit 139/2015”Per Veteqeverisjen Vendore”,i ndryshuar ,si dhe Rregullores se Keshillit Bashkiak Dropull ,pas shqyrtimit te raportit te paraqitur nga sekretari i Keshillit Bashkiak per vitin 2025,,Keshilli Bashkiak :

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit te performances se Keshillit Bashkiak Dropull per vitin 2025”. Sipas raportit bashkangjitur vendimit.
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR

Donika Bauçi



RELACION

RAPORTI I PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK DROPULL PËR VITIN 2025

Këshilli Bashkiak Dropull , si Organi Përfaqësues dhe Vendimmarrës i Qeverisë Bashkiake, ka ushtruar përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë. Këshilli i bashkisë Dropull ushtron funksionin e tij në përputhje me ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", dhe Rregulloren e funksionimit të këshillit të bashkisë Dropull miratuar me vendim të këshillit të bashkisë nr. 14, datë 28.02.2020. Ve primtaria e tij është zhvilluar mbi bazën e parimeve të demokracisë vendore, transparencës, përgjegjshmërisë dhe mbrojtjes së interesit publik, duke përdorur me efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike dhe natyrore.

Raporti i performancës për vitin 2025 pasqyron punën dhe aktivitetet e Këshillit Bashkiak Dropull në zbatim të vendimit nr.7 dt 29.01.2025, "Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit të Bashkisë për vitin 2025".

Gjatë këtij viti këshilli ka ushtruar në mënyrë aktive rolin e tij vendimarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitories, duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje të qytetarëve në proceset e Qeverisjes vendore.

VENDIM MARRJA:

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 Këshilli i bashkisë Dropull ka zhvilluar 14 mbledhje nga të cilat 12 të radhës dhe 2 jashtë radhës me kërkesë të kryetarit të Bashkisë.

Jane miratuar gjithsej 68 vendime prej të cilave 33 vendime normative të cilat janë konstatuar të bazuar në ligj dhe kanë marrë konfirmimin e institucionit të Prefektit, ndërsa nuk ka vendime të pakonfirmuar.

Gjithashtu, për periudhën Janar-Dhjetor 2025 ka pasur 35 vendime me karakter individual. Mbledhjet janë trasmetuar live që komuniteti të ndjek direkt mbledhjet dhe të japë mendime dhe sugjerime e tij për vendimet dhe çështjet që janë shqyrtuar.

Kryesia e Këshillit ka funksionuar rregullisht për çdo mbledhje duke diskutuar për pikat e rendit e ditës propozuar nga ekzekutivi.

Mbledhja e komisioneve janë realizuar 16 mbledhje komisioni. Mbetet sfida agazhimi me I madh I këshilltareve në mbledhjet e komisioneve, si dhe dokumentimi i veprimtarisë, si dhe mendimi i anetareve të komisioneve.

Sekretari i këshillit administron një libër të veçantë (indeks) ku pasqyrohen vendimet e këshillit për periudhën Janar-Dhjetor 2025 në mënyrë kronologjike sipas mbledhjeve të zhvilluara me të dhënat përkatëse.

Sekretari ka administruar kopjen origjinale të të gjitha vendimeve të këshillit për këtë periudhë së bashku me shkresën përcjellëse të konfirmimit nga ana e Prefektit.

Sekretari i këshillit administron procesverbalet ku është pasqyruar ecuria e çdo mbledhjeje. Në hyrje të procesverbalit të mbledhjeve pasqyrohen mungesat dhe nëse ishte i pranishëm numri i nevojshëm i këshilltarëve për zhvillimin e mbledhjes sipas përcaktimit të ligjit. Për çdo vendim të marrë pasqyrohet edhe numri i votave që ka marrë vendimi pro, kundër dhe abstenim. Në fund procesverbalet e mbledhjeve janë firmosur nga sekretari, kryetari, dhe liste prezenca e këshillit. Pjesmarja e këshilltarëve në mbledhjet e këshillit rreth 70%.

Cdo tremujor sekretari i këshillit kontrollohet nga specialistet e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë për aktet normativ dhe individual, për regjistrin, rregulloret dhe zbatimin e tyre.

Jane bërë degjese publike në tre Njesite Administrative për Paketën Fiskale dhe për Buxhetin, për dhenie me qira, për planin e barazisë gjinore, ku janë dokumentuar në regjistrin e konsultimeve Publike dhe është shoqëruar me njoftimin për konsultim publik, kalendarin e takimeve, procesverbalet përkatëse.

PERFAQESIMI

Roli përfaqësues i Këshillit Bashkiak gjatë vitit 2025 është fokusuar në komunikimin e vazhdueshëm me komunitetin, si dhe në terheqjen e emendimeve dhe sugjerimeve, në formë online, ashtu dhe shkresore.

Permirësimi i faqes zyrtare të Këshillit është një proces i rëndësishëm pozitiv.

Për vitin 2025, Këshilli i Bashkisë Dropull, ka përmirësuar ndjeshëm rolin e tij duke miratuar disa akte të cilat rregullojnë funksionet e tij por edhe marrëdhëniet me komunitetin dhe administratën.

Konkretisht:

Është miratuar plan 1 vjeçar i aktiviteteve të Këshillit për vitin 2025, i shoqëruar me buxhetin përkatës, i dedikuar vetëm për këshillin në mënyrë që të realizohen aktivitetet e planifikuara. Paraqitja e shpenzimeve të Këshillit Bashkiak dhe të komisioneve si zë me vetë ku kemi një realizim të kënaqshëm të aktiviteteve dhe planit të konsultimeve të këshillit. E gjithë veprimtaria e Këshillit Bashkiak për vitin 2025, ka synuar rritjen e rolit të tij sidomos fuqizimin e transparencës, organizimin e seancave degjimore me komunitetin dhe grupet e interesit. Për vitin 2025 plani i aktiviteteve është realizuar në masën 92%.

Nuk kemi realizuar plotësisht për periudhën e vitit 2025, shpenzimet operative, që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve, trajnimeve dhe shkëmbimin e eksperiencave me organe analoge. Në këtë drejtim del e nevojshme që fondi i planifikuar për vitin 2026 të shpenzohet për aktivitetet e planifikuara, duke rritur efikasitetin e shpenzimeve të këshillit.

Sfida kryesore e Këshillit për vitin 2025 dhe në vazhdim, ngelet implementimi i rregulloreve dhe planit të aktiviteteve në praktikë. Për këtë qëllim është i nevojshëm bashkëpunimi i gjithë këshilltarëve, administratës si dhe komunitetit.

Në procesin e shqyrtimit dhe implementimit të këtyre rregulloreve këshilli është asistuar nga Projekti “Bashki të Forta” i cili do vazhdojë edhe për këtë vit të asistojë për të bërë të mundur implementimin e këtyre standarteve në mënyrë që të rritet roli i Këshillit të Bashkisë.

Gjithësesi, nuk kanë munguar as takimet direkte të këshilltarëve me banorët e Bashkisë Dropull dhe përcjellja e mendimeve të tyre Komisionit të Ekonomisë, Buxhetit dhe Tatimit dhe Taksave dhe janë përfshirë në buxhetin e vitit 2025.

Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik i ankesave/kërkesave dhe një regjistër fizik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbëritura në drejtim të Këshillit të Bashkisë. Kërkesat janë trajtuar dhe janë koordinuar me ekzekutivin e bashkisë dhe në të gjitha rastet janë informuar qytetarët. Gjithsej 22 kërkesa miratuar 80%.

MBYKQYRJA:

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruar nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2025 u realizuan dhe u paraqitën në këshill informacione dhe raporte nga administrata sipas kërkesave të bëra nga vetë këshilli.

Gjate periudhes raportuese ,ne keshillin Bashkiakjane paraqitur keto raportime dhe informacione nga administrata e Bashkise Dropull:

Raporti i monitorimit te zbatimit te buxhetit per 4-mujorin e pare te vitit 2025.

- Informacion nga Drejtoria e MZSH mbmasat paraprake per parndalimine zjarreve dhe perballimin e emergjencave civile.
- Raportim nga Drejtoria ekonomike per menaxhimin financiar dhe zbatimin e buxhetit
- Raportim nga Drejtoria e Sherbimeve per problematikat e shirave .
- Raportim nga Drejtoria e te ardhurave per realizimin e te ardhurave.
- Informacion : Për Raportin e Monitorimit te Zbatimit të Buxhetit të 8-mujorit 2025 .
- Informacion mbi rezultatet e Barometrit Gjiner organizuar nga Keshilli Bashkiak ,Komisioni I barazise gjinore dhe Aleanca e grave keshilltare .
- Informacion për ecurinë e nismës për asistencën sociale në banese për PAK dhe të moshuar kerkuar nga komisioni i barazisë gjinore dhe aleanca e grave keshilltare.

Në këtë drejtim, duke qënë se edhe për vitin 2026, në planin e aktiviteteve të miratuar janë planifikuar një sërë informacionesh dhe raportesh nga të cilat një pjesë e mire janë edhe detyrime ligjore për t'u shqyrtuar nga këshilli, do ishte e nevojshme një bashkëpunim më i mirë me administratën dhe një angazhim më i madh për ekzekutivin, që të pregatisë në kohë raportet dhe informacionet e planifikuara në planin e aktiviteteve të këshillit por edhe për rastet kur do të kërkohen nga këshilli.

Keto raporte duhet te perbajne te dhena konkrete mbi procesin e ndjekur per zbatimin e vendimit ,masat e marra nga strukturat pergjegjese, afatet e realizimit,apo problematikat e hasura gjate zbatimit te metejshem.

Ne perfundim,duke ju falenderuar secilin per kontributin dhe angazhimin,ju ftoj te beheni pjese active per permiresimin e punes se keshillit nepermjt mendimeve dhe pjesmarje suaj ne aktivitetin eKB.

Ju faleminderit.

SEKRETAR I KESHILLIT

URANIA KUREMENO

